



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2018-01
Vendosi: Gjykatësi i Vetëm
Gjykatësi Nikola Giju
Administratorja: Dr. Fidelma Donlon
Data: 25 shtator 2020
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

**Vendimit mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për urdhër lidhur me
dokumente jopublike dhe konfidenciale**

Prokurori i Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësve të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtësve të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

GJYKATËSI I VETËM¹ ka marrë në shqyrtim parashtrimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* me titull “Njoftim i Prokurorisë dhe kërkesë në lidhje me të”², protokolluar- të mërkurën, më 23 shtator 2020, dhe në vijim jep vendimin e tij.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi një njoftim për zbatimin e një urdhri sipas nenit 35(2) dhe 53(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) lidhur me Hysni Gucatin (“z. Gucati”) dhe Organizatën e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”) dhe kërkesën e ndërlidhur për dhënien e një urdhri nga Gjykatësi i Vetëm (“Kërkesa”).³

II. PARASHTRIME

2. ZPS-ja parashtron se, më 22 shtator 2020, OVL-UÇK-ja deklaroi se kishte marrë dokumente që pretendohej se lidheshin me ZPS-në (“dokumentet”) të cilat, në bazë të pamjeve të bëra publike, u vlerësuan prej saj se [REDAKTUAR].⁴ Në këto rrethana, ZPS-ja vendosi se ishte e nevojshme që dokumentet të merreshin menjëherë, me qëllim që të mblidheshin dhe ruheshin provat e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe të shmangej rreziku i menjëhershëm i dëmit të rëndë dhe të pakthyeshëm ndaj dëshmitarëve dhe personave të tjerë.⁵

¹ KSCPR-2018, F00004, Kryetari, *Vendim për caktimin e një Gjykatësi të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

² KSC-BC-2018-01, F00126, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë dhe kërkesë në lidhje me të*, 23 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ *Shih* poshtëshënimin 2 më lart.

⁴ Kërkesa, para. 1.

⁵ Kërkesa, para. 2.

3. ZPS-ja kontaktoi OVL-UÇK-në dhe u informua nga zoti Gucati se mund t'i merrte dokumentet.⁶ Ajo lëshoi gjithashtu një urdhër për z. Gucati dhe/ose OVL-UÇK-në që: (i) të dorëzonin të gjitha dokumentet dhe të dhënat, [REDAKTUAR] së ZPS-së; dhe (ii) të mos incizonin apo kopjonin në asnjë lloj forme dhe të mos shpërndanin më tej me asnjë lloj mjeti komunikimi, dokumentet apo përmbajtjen e tyre ("urdhri i ZPS-së").⁷ Në vijim, ZPS-ja shkoi në zyrat e OVL-UÇK-së, i dorëzoi OVL-UÇK-së urdhrin e ZPS-së dhe mori disa dokumente të caktuara.⁸

4. ZPS-ja parashtron se: (i) ajo veprroi në përputhje me autoritetin e saj në bazë të neneve 35(2) dhe 53(1) të Ligjit; (ii) urdhri i ZPS-së u kufizua vetëm në dokumentet e ZPS-së; dhe (iii) në ato rrethana, zbatimi i urdhrin të ZPS-së nuk parashikonte dhe nuk përfshiu ndonjë kontroll apo ndërhyrje tjetër të detyruar në zyrat e OVL-UÇK-së, çka kërkon një pritshmëri e arsyeshme për privatësi, dhe si rrjedhojë rregullat 37-39 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") nuk janë të zbatueshme.⁹ Megjithatë, për të qenë e kujdesshme, ZPS-ja po e njofton Gjykatësin e Vetëm për masat e marra dhe, nëse Gjykatësi i Vetëm mendon se rregullat 37-39 të Rregullores kanë qenë të zbatueshme në rrethanat e lartpërmendura, ajo kërkon miratimin e kërkuar sipas rregullës 38(2) të Rregullores.¹⁰

5. Së fundi, në dritën e informacionit të disponueshëm lidhur me rrezikun se OVL-UÇK-ja të mund të ketë qasje të paautorizuar në këto dokumente dhe se mund të shpërndajë dokumente të tjera jopublike dhe konfidenciale, ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Vetëm:

- (a) Të urdhërojë z. Gucati, OVL-UÇK-në, dhe çdo përfaqësues, anëtar, apo person që punon për ta që: (i) të njoftojnë menjëherë ZPS-në nëse kanë në zotërim apo nëse në të ardhmen marrin dokumente të tjera që duket se janë konfidenciale

⁶ Kërkesa, para. 3.

⁷ Kërkesa, para. 4; KSC-BC-2018-01, F00126/A01, shtojca 1 e Kërkesës.

⁸ Kërkesa, para. 4.

⁹ Kërkesa, para. 5.

¹⁰ Kërkesa, para. 6.

apo jopublike dhe lidhen me Task Forcën Hetimore Speciale ("TFHS"), me hetimet apo dëshmitarët e ZPS-së, ose me procedurat e Dhomave të Specializuara; dhe (ii) të mos incizojnë apo kopjojnë në asnjë formë dhe të mos shpërndajnë me asnjë lloj mjeti komunikimi, dokumente të tilla apo përmbajtjen e tyre në mungesë të një autorizimi nga ZPS-ja apo Gjykatësi i Vetëm; dhe

(b) Të paralajmërojë se çdo shkelje e një urdhri të tillë mund të përbëjë vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, nr. 06/L-074 ("Kodi Penal"), në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.¹¹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Sipas nenit 39(3) dhe (11) të Ligjit, me kërkesë të Prokurorit të Specializuar, Gjykatësi i Vetëm mund të lëshojë çfarëdo urdhri që mund të kërkohej për kryerjen e hetimeve dhe, kur është e nevojshme, të sigurojë mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe dëshmitarëve, ruajtjen e provave dhe mbrojtjen e personave.

7. Sipas nenit 53(1) të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë duhet të përmbushin pa vonesë të papërligjur çdo kërkesë për ndihmë, urdhër, apo vendim të nxjerrë nga Dhomat e Specializuara.

8. Sipas nenit 62(1) të Ligjit, duke marrë parasysh aspektet e sigurisë dhe të privatësisë, dokumentet, shkresat, të dhënat dhe arkivat e Dhomave të Specializuara, të Zyrës Administrative dhe ZPS-së nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës.

¹¹ Kërkesa, para. 7.

IV. DISKUTIM

A. MBLEDHJA E DOKUMENTEVE NGA ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

9. Gjykatësi i Vetëm konstaton se, përpara se të shkonte në zyrat e OVL-UÇK-së, ZPS-ja u informua nga z. Gucati se mund t'i merrte dokumentet.¹² Gjithashtu konstatohet se urdhri i ZPS-së, dorëzimi i të cilit u konfirmua nga Nasim Haradinaj,¹³ u bazua në nenet 35(2) dhe 53(1) të Ligjit.¹⁴ Më tej, Gjykatësi i Vetëm konstaton se urdhri i ZPS-së nuk parashikonte ndonjë kontroll apo ndërhyrje të detyruar në mjediset e OVL-UÇK-së dhe se nuk u bë asnjë kontroll në OVL-UÇK.¹⁵ Së fundi, dokumentet duket se i janë dhënë ZPS-së me vullnet të lirë, pas dorëzimit të urdhrit të ZPS-së.¹⁶ Në këto rrethana, nuk kërkohet autorizim sipas rregullës 38(3) të Rregullores.

B. URDHRI I KËRKUAR

10. Gjykatësi i Vetëm konstaton se, sipas informacionit të dhënë nga OVL-UÇK-ja, OVL-U ÇK-së mund t'i jepen dokumente të tjera jopublike dhe konfidenciale të lidhura me punën e të TFHS-së, ZPS-së, dhe/ose të Dhomave të Specializuara.¹⁷ Duke marrë parasysh rreziqet shoqëruese për integritetin e hetimeve të ZPS-së dhe procedurat gjyqësore të Dhomave të Specializuara, si edhe për sigurinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve të mundshëm dhe të personave të tjerë, Gjykatësi i Vetëm e quan me vend që të miratojë Kërkesën dhe të lëshojë një urdhër në pajtim me nenet 39(3) dhe (11), 53(1), dhe 62(1) të Ligjit për t'i kërkuar OVL-UÇK-së dhe çdo përfaqësuesi, anëtari, apo personi që punon për ta që: (i) të njoftojnë menjëherë ZPS-në nëse kanë në zotërim apo nëse marrin në të ardhmen çfarëdo dokumentesh që duket se janë konfidenciale apo jopublike dhe që lidhen me punën e TFHS-së, ZPS-së apo të

¹² Kërkesa, para. 3; KSC-BC-2018-01, F00126/A01, shtojca 1 e Kërkesës.

¹³ Kërkesa, poshtëshënimi 1.

¹⁴ Kërkesa, para. 3-4; KSC-BC-2018-01, F00126/A01, shtojca 1 e Kërkesës.

¹⁵ Kërkesa, para. 5.

¹⁶ Kërkesa, poshtëshënimi 1.

¹⁷ Kërkesa, poshtëshënimi 5.

Dhomave të Specializuara, dhe (ii) të mos incizojnë apo kopjojnë në asnjë lloj forme dhe të mos shpërndajnë me asnjë mjet komunikimi dokumente të tilla apo përmbajtjen e tyre në mungesë të një autorizimi nga ZPS-ja ose Gjykatësi i Vetëm. Gjykatësi i Vetëm gjithashtu e quan me vend të paralajmërojë OVL-UÇK-në dhe çdo përfaqësues, anëtar, apo person tjetër që punon për të, se çdo shkelje e urdhrit të lartpërmendur mund të përbëjë një vepër penale sipas Kodit Penal.

C. ZBATIMI DHE DORËZIMI I URDHRIT TË KËRKUAR

11. Sipas nenit 35(3) të Ligjit, policia brenda ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar të drejta që i janë dhënë Policisë së Kosovës, në bazë të legjislacionit të Kosovës dhe mund të konsiderohet “autoritet kompetent” në bazë të rregullës 49(1) të Rregullores për të zbatuar dhe dorëzuar urdhrat e Dhomave të Specializuara, duke përfshirë edhe urdhrin bashkëlidhur.¹⁸

V. VENDIMI

12. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

- a. **MIRATON** Kërkesën;
- b. **LËSHON** urdhrin bashkëlidhur për t’iu dorëzuar çdo përfaqësuesi të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sipas rastit; dhe
- c. **AUTORIZON** ZPS-në që urdhrin bashkëlidhur ta bëjë të ditur, në qoftë se është e përshtatshme dhe e nevojshme për zbatimin e tij.

¹⁸ Me informimin e Prokurorit të Specializuar për këtë vendim, transmetimi i tij konsiderohet i kryer në përputhje me rregullën 49(1) të Rregullores.

/nëshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Vetëm

E premte, 25 shtator 2020

Në Hagë, Holandë.